



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

NJOFTIM
PËR MBLEDHJE PLENARE
30 MARS 2023

Informacion mbi mbledhjen:

Dita/Data:	E enjte, 30.03.2023
Ora:	10.00
Kohëzgjatja:	~ 120 min
Thirrur nga:	Kryetari i Këshillit
Pjesëmarrësit:	Anëtarët
Kuorumi i nevojshëm:	7 anëtarë

Kjo mbledhje do të organizohet në sallën e mbledhjeve të Këshillit, në prezencë të Anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si dhe të ftuar përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, Prokurori i Përgjithshëm dhe Programi OPDAT. Media si gjithmonë është e ftuar të jetë e pranishme.

Rendi i ditës:

1. Diskutimi/miratimi i procesverbalit të Seancës Plenare të datës 21.03.2023.
2. Diskutimi/miratimi i procesverbalit të Seancës Plenare të datës 24.03.2023.
3. Diskutimi/miratimi i projekt-aktit “Mbi kërkesën për rishikim të Vendimit Nr.76, datë 04.03.2020 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të zotit Besnik Cani”.
4. Diskutimi/miratimi i projekt-aktit për përcaktimin e rregullave dhe arsytet e lejimit të magjistratit të diplomuar për t’u emëruar në vitin pasardhës.
5. Diskutimi/miratimi i projekt-aktit “Për dhënien e lejes së papaguar për magjistratët prokurorë”.
6. Hedhje e shortit “Për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Përkohshëm për Shqyrtimin e Ankesave kundër Vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për Arkivimin e Ankimit ose Pushimin e Hetimit ndaj një Prokurori”.
7. Diskutimi/miratimi i projekt-aktit për “Miratimin e komenteve dhe kundërshtimeve ndaj raportit të vlerësimit paraprak të kandidatëve që kanë aplikuar për pranimin në formimin fillestar, në vitin akademik 2023-2024”, profili prokuror, të shkollës së magjistraturës.”

Të tjera (pyetje/diskutime).

Urdhërohet sektori i dokumentimit të seancave të bëj publikimin e kësaj axhende në faqen Web të Këshillit.

Njoftohen të gjithë anëtarët e Këshillit për të siguruar pjesëmarrjen

Kryetar
Alfred Balla